



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 11, datë 08.07.2016

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT DHE NDRYSHIMI
I SUBJEKTEVE ZHVILLUESE PËR RESORTIN TURISTIK “NEW BORN”

Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, neneve 13 dhe 17 të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 1097, datë 28.12.2015 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërive “Mane TCI” sh.p.k, “Startek” sh.p.k, “Alentre” sh.p.k dhe “Uni-Invest” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit të resortit turistik “New Born”, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 10, datë 10.05.2013, me subjekte zhvilluese shoqëritë “Mane TCI” sh.p.k, “Startek” sh.p.k, “Alentre” sh.p.k dhe “Uni-Invest” sh.p.k.
2. Krahas subjekteve zhvilluese “Mane TCI” sh.p.k, “Startek” sh.p.k, “Alentre” sh.p.k, shtohet edhe shoqëria “Uni-Invest” sh.p.k.
3. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr. 10, datë 10.05.2013, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Urban për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



ZËVENDËS KRYETAR I KKT

EGLANTINA GJERMI

MINISTER I ZHVILLIMIT URBAN



SEKRETARI I KKT

LEDIA STOTA

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT